



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1

Aksident tragjik në Lushnjë, automjeti del nga rruga dhe përfundon në kanal! 2 motra humbin jetën, u mbytën nga uji (VIDEO)
- 2

‘Turizmi i lindjeve’ në SHBA, Trump firmos 2 urdhra për ta ndaluar! Jo më nënshtetësi automatike për foshnjat
- 3

Norvegjia kërkon dorëheqjen e Infantinos, Meksika dhe Argjentina mbështesin presidentin e FIFA-s
- 4

Ben Blushi: A mund të bëhet Shqipëria një shtet më i madh sipas Marko Rubios?
- 5

Gjykata ‘kundërvihet’ Trump, ndal ndërtimin e sallos së ballave prej 400 mln \$: Presidenti është banor, jo pronar i Shtëpisë së Bardhë

Kronikë

Sherr në lokalin në Divjakë, 22-vjeçari kthehet të vrasë 51-vjeçarin! 6 në pranga, 3 me precedent penalë për drogë (EMRAT+VIDEO)

Një sherr me sende të forta u shënua në një lokal të Divjakës, me dy të lënduar. Teksa policia hetonte të zbulonte të gjithë të përfshirët, njëri prej tyre, një 22-vjeçar me precedentë për drogë në Shqipëri dhe Belgjikë, u rikthye disa orë më pas në lokal dhe tentoi të vriste me një pistoletë me silenciator, personin me të cilin u konfliktua. Nga hetimet, u arrestuan në total, 6 persona.

Sherr në Divjakë, 22-vjeçari kthehet të vrasë 51-vjeçarin! 6 në pranga,

Report TV



Watch on

[Sh] Redaksia
13 Gusht, 10:55 | Përditësimi: 13 Gusht, 15:35

Share Post



Një **sherr** me sende të forta u shënua në një lokal të Divjakës, ku pas njoftimit në sallën operative, policia ndërhyri duke arrestuar 6 persona.

Fillimisht policia i gjeti të dëmtuar me sende të forta në lokal, 22-vjeçarin **Orgito Lamka** dhe 51-vjeçarin **Shahin Xhepexhiu**. Të dy morën mjekim, dhanë deklarime në komisarariat dhe u larguan të lirë.

Por teksa policia kryente hetime për të zbuluar të gjithë të përfshirët në sherr, 22-vjeçari Lamka, disa orë më vonë është rikthyer në lokal me një pistoletë me silenciator, dhe dyshohet se do të vriste 51-vjeçarin Shahin Xhepexhiu.



LEXO EDHE:
Aksident tragjik në Lushnjë, automjeti del nga rruga dhe përfundon në kanal! 2 motra humbin jetën, u mbytën nga uji (VIDEO)

Ndërhyrja në kohë e shërbimeve të Policisë parandaloi vrasjen.

Në vijim të hetimeve, blutë arrestuan të riun Orgito Lamka, i cili sipas policisë është me precedent penalë në fushën e prodhimit dhe shitjes së narkotikëve në Shqipëri dhe Belgjikë. Atij iu gjet pistoletë me silenciator me fishekë në fole, gati për qitje.

Personi që drejtonte makinën me të cilin i riu u rikthye në lokal, u arrestua, **Serxhio Duda**, 28 vjeç, edhe ky me precedent penalë për drogë në vendin tonë.

Edhe 51-vjeçari i cili ishte shënjestër e të riut, u arrestua për moskallëzim të krimit, pasi sipas policisë gjatë deklarimit nuk ka treguar të vërtetën në lidhje me konfliktin.

Në pranga përfundoi edhe **Kevin Sota**, 45 vjeç, gjithashtu me precedent penal në fushën e prodhimit dhe shitjes së narkotikëve në Shqipëri. Në makinë, blutë i sekuestruan një pistoletë, të cilën më herët kishte tentuar ta fshihte, 30-vjeçari **Santiago Alla**, i vënë në pranga.

Lokali është në pronësi të Zeni Kules, 50 vjeç, i cili u arrestua për moskallëzim të krimit.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë.

P.J/E.H/Shqiptarja.com

TAG: sherr zeni kule santiago alla kevin sota serxhio duda shahin xhepexhiu orgito lamka divjakë

Fier

Sa e vlerësoni këtë artikull? 3.8 / 5 (4 vlerësime)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento



Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës:
A mendoni se Shqipëria është e përgatitur për sezonin e zjarreve?

9 Gusht, 17:40

Po Jo I/e dyzuar

Lajme të tjera



Fier/ Përfshihet nga flakët masivi pyjor i Peshtanit, zjarri larg zonave të banuara (VIDEO)

13 Gusht, 20:11



Humbi kontrollin e makinës dhe u përplas me shtyllën, ndërron jetë 82-vjeçari në Divjakë (EMRI)

13 Gusht, 18:10




Vënia nën kontroll e flakëve në Drenie të Patosit e Lofkand, shefi i emergjencave pranë Prefekturës Fier: Po monitorojmë të gjithë perimetrin e vatrave të zjarrit

13 Gusht, 15:45



Prej disa ditësh në flakë, izolohet vatra në Drenie të Patosit

13 Gusht, 10:57



Fier/ Përparon zjarri në Drenie të Patosit, forcat zjarrfikëse po punojnë për garantimin e një perimetri sigurie pranë banesave (VIDEO)

12 Gusht, 23:16



Divjaka 13 ditë rezistencë, banorët kundërshtojnë bashkimin me Lushnjen: S’jemi kundër lushnjarëve, por kundër politikanëve (VIDEO)



Yrjet Saliasi

12 Gusht, 22:51



Kamera e Report TV kap momentin e rrallë, transformimi magjik i qiellit mbi Fier nga eklipsi diellor

12 Gusht, 20:30



‘Territorialja’, këshilli bashkiak i Divjakës firmos kërkesën: ‘Jo’ bashkimit me Lushnjen, kemi kapacitete të mjaftueshme për funksionimin

12 Gusht, 16:16



‘Duan qiranë e tokës’, banorët e Patos-Marinëz përplasen me rojet e ‘Bankers Petroleum’: Do e përshkallëzojmë protestën



Marsela Topi

12 Gusht, 14:13



Sherri në burgun e Fierit mes Denis Bajrit, Aldo Gjinit të ‘Rrajave’ e Jurgen Zotos, një kryeinspektor dhe 7 gardianë të pezulluar

12 Gusht, 10:53



‘Luftë’ me zjarret/ Disa vatra rreth Tiranës, situatë ‘alarmante’ mes Lundrës e Priskës, digjen disa shtëpi të pabanuara! Në Lurë rrezikohen banesat! Krutanët largojnë fëmijët e të moshuarit

12 Gusht, 07:32



‘Territorialja’/ Banorët e Divjakës për të 12-ën ditë në protestë, kundërshtojnë bashkimin me Lushnjën: Të bëjmë rezistencë!

11 Gusht, 22:53



‘Karamele’ në mes të bulevardit kryesor në Durrës, instalacioni i veçantë para godinës së bashkisë (VIDEO)

13 Gusht, 20:34



×

[Sh]

.com

Lajmi i fundit



‘Karamele’ në mes të bulevardit kryesor në Durrës, instalacioni i veçantë para godinës së bashkisë (VIDEO)

13 Gusht, 20:34